

**RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS I PROJEKTIT “
STUDIM PROJEKTIM PËR PUNIME NDËRTIMI PËR SHITESE AMBJENTESH NË
SHKOLLEN E MESME “DILAVER NEZHA“-QUKES SHKUMBIN“, NJ/A QUKES,
BASHKIA PIRENJAS”**



RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS U PERGATIT NG:

Lorenc
Hoxha

Digitally signed by
Lorenc Hoxha
Date: 2024.09.27
10:08:01 +02'00'

Konsulent: ZETA KOSNULT SH.P.K - ZENIT & CO SH.P.K
Drejtues Ligjor
Ing. Lorenc Hoxha

Përgatiti: Expert Mjedisi/Ing. Yzeir Miraka
Ing. Bestar Cekrezi

Yzeir
Miraka

Digitally signed by Yzeir
Miraka
Date: 2024.09.06
15:38:56 +02'00'

TIRANË 2024

Adresa; Myrteza Topi Nd.18, Tirana - Albania

Tel:00355 (0) 69 33 52 077
e-mail; zetakonsultshpk@gmail.com

1. Hyrje

Në këtë raport paraqitet Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin “STUDIM PROJEKTIM PËR PUNIME NDËRTIMI PËR SHITESE AMBJENTESH NË SHKOLLEN E MESME “DILAVER NEZHA“-QUKES SHKUMBIN“, NJ/A QUKES, BASHKIA PRRENJAS. Zone ne te cilen ndohdet objekti arsimor eshte ne zonen kadastrale 3120, numri i pasurise 192. Shkolla ka nje gjurme ndertimi prej 351.8 m², ndersa gjurma e godiens qe do t shtohet eshte 333.4 m² dhe do te ngrihet ne lartesine e dy kateve me Çati. Siperfaqja Totale e ndertimit të godines se re do te jete rreth 666.8 m².




Figura 1. Vendodhja e projektit

Objekti i ri do te zhvillohet eshte ne prone publike edhe ambientet e shkolles egzistuese. Bazuar në kërkesat e detyres se projektimit dhe ne kushtet teknike te projektimit per objektet me destinacion edukimi jane marre parasysh te gjitha kondicionet urbane te planifikimit ne fuqi. Projekti ofron nje objekt dhe zgjidhje funksionale ne perputhje me KTP dhe KTZ.



Elbasan përfshin Planifikimin, Rehabilitimin dhe Masat zbutëse të ndikimit të projektit në këtë zonë.

2.3 Kuadri Ligjor

Gjate dhjetëvjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore të cilat kanë ardhur si rezultat i industrisë para viteve 90-të dhe zhvillimeve të fundit. Bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"

Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59 (d) shkruhet se:

- Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:
- Një Mjedis të shëndetshëm dhe Ekologjikisht të Pershtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.
- Legjislacioni kërkon që Kondicionet Urbane të shfrytëzohen në përputhje me principe të bazuara.

Kapitulli II "Politikat Mjedisore" përcakton politiken e qeverisë për:


- Politika Shtetëror Mjedisor përcakton pozicionin e mjedisit në Legjislacion, vendin e strategjive të sektoreve Kombëtar dhe planet lokale si pjesë e politikës mjedisore dhe përcakton organizmat të cilët do të administrojnë këto politika.

Programet dhe strategjitë mjedisore: Përcakton planin e veprimit kombëtar të mjedisit (PVKM) i cili duhet të hartojë çdo dhjetë vjet një raport mjedisor në zbatimin e PVKM për Keshillimin e Ministrave.

- Plani lokal mjedisor: kërkojnë nga qeveria lokale të zhvillojnë Planet Lokale të Vepnit të Mjedisit (PLVM) duke përdorur Organizmat Kombëtar për të ofruar të dhëna dhe mbështetje teknike; për Qeveritë Lokale që të lidhen me publikun, OJF dhe Biznesin për zhvillimin e planeve, kryetaret e Bashkive të raportojnë në Keshillin e Rretheve për Zbatimin e planeve në fund të viti.

Pergatitja e këtij raporti të VNM-se kërkon me domosdoshmëri respektimin e Paketës Ligjore Mjedisore, ku me poshtë po përmendim me kryesoret që janë marrë në konsiderat gjatë përgatitjes së këtij material!

- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (ndryshuar)
- Ligji Nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
- Ligji Nr.9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta".
- Ligji Nr.10448 datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit"
- Ligji Nr.10266, datë 15.04.2010 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Ligji Nr.9115 datë 24.07.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura".
- Ligj nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore"



- *(Ky vendim synon të bëjë përafrimin e plotë të Direktivës 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2011, "Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private" (celex-32011L0092, OJ. L 26, 28.1.2012), të ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 prill 2014 (celex-32014L0052, OJ. L 124, 25.4.2014).)*

A handwritten signature in blue ink is written over a faint, circular official stamp. The stamp contains some illegible text and a date that appears to be "2014-07-15".

përqindjen e popullsisë aktive, mes meshkujve (25.6%) dhe femrave (29.5%). Shpërndarja e papunësisë ndryshon nga zonat urbane në ato rurale, këto të fundit numërojnë rreth dyfishin e banorëve papunë të zonave urbane, ndonëse përqindja e papunësisë në raport me popullsinë totale përmbys plotësisht këtë raport duke bërë që shkalla e papunësisë në zonat rurale të jetë shumë më e vogël në krahasim me zonat urbane. Kjo vjen si pasojë e përqendrimit të popullsisë në qytete dhe zonat periferike rreth tyre. Grafiku që vijon vë në dukje këtë fenomen.

Shkalla e papunësisë e analizuar sipas grupmoshave tregon që ky tregues është më i lartë ndër të rinjtë (shkalla e papunësisë ishte më e lartë për grupmoshën 15-39 vjec dhe vjen duke u ulur me rritjen e moshës. Femrat mbeten kategoria me shkallën më të lartë të popullsisë dhe hendeku më i thellë mes dy gjinive regjistrohet për grupmoshën 30-39 vjec.

NJA	Familje gjithsej	Familje me ndihmë ekonomike		Me aftësi të kufizuar (PAK+Invalid Pune)
		Numri	Në % ndaj totalit	Numri
Prenjas	2926	257	2.32%	603
Rrajcë	3634	629	5.69%	698
Qukës	3521	603	5.45%	652
Stravaj	972	255	2.3%	254
Shuma	11053	1744	15.76%	2207

Tabela 5. Familjet me ndihmë ekonomike e aftësi të kufizuar, Bashkia Prrenjas

Burimi: Zyra e Ndihmës Ekonomike, Bashkia Prrenjas

Të dhënat mbi numrin e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike janë një tregues indirekt i nivelit të varfërisë në Bashkinë Prrenjas. Këtë ndihmë e përfitojnë në total rreth 1744 familje, nga të cilat 257 në qytetin e Prrenjasit. Në raport me numrin total të familjeve, rezulton se në Bashkinë e Prrenjasit përfitojnë ndihmë ekonomike rreth 15.76 % e familjeve.

3.4 Bizneset dhe Institucionet

Në të gjithë bashkinë e re rezultojnë të regjistruara 452 biznese të cilat e kryejnë aktivitetin e tyre kryesisht në shërbime. Një pjesë e vogël e bizneseve merren me kultivimin e troftës.

Nr.	Biznese sipas aktivitetit	Totali	Sipas NJA			
			Prrenjas	Rrajcë	Qukes	Stravaj
A	Institucione	2	2			
B	Shoqata	0	0	0	0	0
C	Biznese	381	239	74	30	6

Tabela 6: Shpërndarja e institucioneve dhe bizneseve sipas NJA

Burimi: Zyra e Taksave vendore, Bashkia Prrenjas

3.5 Burimet natyrore dhe qëndrueshmëria mjedisore

4. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti

Në këtë raport paraqitet Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin Studim projektim për punime ndërtimi për shtese ambjentesh në shkollën e mesme “Dilaver Nezha”-Qukes Shkumbin“, nj/a Qukes, Bashkia Brrenjas”, Zone në të cilën ndodhet objekti arsimor është në zonën kadastrale 3120, numri i pasurisë 192. Shkolla ka një gjurmë ndërtimi prej 351.8 m², ndërsa gjurma e godinës që do të shtohet është 333.4 m² dhe do të ngrihet në lartësinë e dy kateve me Çati. Sipërfaqja Totale e ndërtimit të godinës së re do të jetë rreth 666.8 m².



Figura 8. Foto aktuale nga sheshi i objektit egzistues të shkolles

6. Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe kerkesave te VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e demtimi. Kjo perben perparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Cdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e meposhtme:

- Njohja me proceset e punës
- Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do zhvillohet aktiviteti

Duke analizuar natyren e te gjithe proceseve dhe format e shfaqjes se tyre, direkte ose indirekte, percaktohet qarte lloji i ndikimeve. Te gjitha ndikimet mund te minimizohen ne terma relative ku qellimi kryesor eshte mbajtja e tyre brenda siperfaqes se objektit te kerkuar dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizim te proceseve te natyres dhe rigjenerim te ekosistemit.

6.1 Ndikime te rendesishme gjate ndertimit

• Shkarkime ne uje

Nuk kemi ndotje te ujerave nentokesore. Ujerat qe dalin nga aktiviteti i ndertimit te objektit jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lagies se kantierit, larjes se gomave te automjeteve dhe ujerat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Gjate ndertimit, ne varesi edhe te rreshjeve te shiut, mund te grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujerave dhe si rrjedhoje mund te jete i nevojshem grumbullimi i ketyre ujerave dhe orientimi i tyre ne sistemin e kanalizimeve, pjeserisht ato filtojne nentoke. Si rrjedhoje, punimet e ndertimit nuk duhet te tejzgjaten dhe te kalojne afatet e percaktuara ne lejen e ndertimit.

Nuk duhet te shkarkohen lende te demshme ne mjedisin e kantierit pasi mund te filtojne se bashku me ujerat e rreshjeve dhe si rrjedhoje te ndosin ujerat nentokesore. Ne kantier nuk do te magazinohen materiale te rrezikshme dhe si rrjedhoje nuk do te kete ndotje te ujerave nentokesore ose siperfaqesore. Mundesite e ndotjes, mund te vijne vetem nga derdhja e hidrokerbureve ose e lubrifikanteve gjate furnizimit te mjeteve te renda te punes. Nje faktor tjeter mund te jene ujerat e pastrimit e te larjes se kazaneve te betoniereve gjate shkarkimit te betonit ne kantier. Keto te fundit, nuk duhet te shkarkojne ujerat ne odo mjedis rrethanor, ato duhet te shkarkohen ne mjedis te caktuara dhe ne kantieret e prodhimit te betonit. Punimet e

ndertimit. Materialet te cilat jane te riperdorshme, mund t'ju jepen individeve te interesuar per punime ndertimi ne zonat periferike ose rehabilitim te lulishteve ose mbushje te tokave aty ku ka nevojë, pjesa e mbetjeve te pa perdorshme duhet te grumbullohen ne vendin e caktuar nga Njesia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V) pas zbardhjes se Lejes se Zhvillimit nga autoritetet pergjegjese. Keto mbetje duhet te menaxhohen ne bashkepunim me Njesine Qeverisjes vendore Qukes dhe firmen pastruese te territorit dhe ne perputhje me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".

Grumbullimi i mbetjeve duhet te jete i diferencuar qe ne vendburim. Mbetjet inerte, apo edhe dheu i germuar, materiale te ndertimit duhet te trajtohen ne menyre te veçante. Ne kete faze nuk kemi informacion per menyren e menaxhimit te mbetjeve inerte. Landfilli ku do te depozitohen keto mbetje duhet qe te jete i pajisur me leje mjedisore dhe i miratuar me vendim te Keshillit Bashkiak.

Bazuar ne ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" si dhe VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", ku volume i mbetjeve te ngurta do te trajtohet sipas legjislacionit ne fuqi. Nuk parashikohet nje volum i madh te mbetje te ngurta, ku kryesisht jane sterilet qe perbejne terrenin ne vetvete, ku referuar territorit te zones, jane dhera.

Mbetjet nga shembja e ndertesegjzistuese do te perdoren per nivelimin e sheshit te ndertimit qe jane kryesisht tulla, suva edhe tjegulla. Mbetjet qe nuk do te riperdoren do te dergohen ne vendet e grumbullimit te mbetjeve inerte te bashkise Pirenjase.

Referuar VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", mbetjet e gjeneruara i klasifikohen sipas pikve:

Pika 13 Mbetje vajrash dhe mbetje te karburanteve te Lëngshme

1301- Mbetje te vajrave hidraulike

1302- Mbetje vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikante

Pika 16 Mbetje te pa specifikuara

16 01 03- Goma jashtë përdorimi

Pika 17. Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhera të germuara nga zona të kontaminuara)

1701- Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika

1702- Dru, qelqe dhe plastika

1705- Dhera

Emetimet me të medha pluhurave mund të ndodhin gjatë oreve të punës në aktivitetet e germimeve e ato ndertimore. Pluhuri nuk shkakton ndryshime të gjata ose të gjera afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në objektet e afërta shkakton ndotje dhe për këtë arsye mund të rezultojë në ankesa por që keto ndikime janë të përkohshme, ose gjatë fazes përgatitore dhe asaj të ndërtimit.

Ndërsa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë dhe që mund të transportohen më gjërë sesa pluhuri, nëpërmjet eres, grimca të lëshuara edhe nga motorët të tilla si kompresorë, gjeneratorë, etj. Si madhësia e emisioneve PM10 është relativisht i vogël, çdo efekte anësore që rezultojnë prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efekte të rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit.

Ndërsa gjatë fazës së operimit, ndikimi mund të zbutet duke marrë masat e duhura, të ngjashme me fazën e ndërtimit edhe perodrimi I filtrave të posacem nese do ishte e mundur për grimcat, lagia e sheshit me uje kohe pas kohe në ditët me diell.

Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme nga zhurmat dhe vibrimet

Zhurma dhe dridhjet do të gjenerohen kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të jenë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si fadromat, vinça, etj. Reagimi i njerëzve për të vibracioneve në terren është e ndikuar nga shumëfaktorë fizike ku përfshihet dhe kohezgjatja. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme. Për shkak të faktit se nuk ka prona banimi në afërsi të objektit, ka gjasa që vibrimet nga ndërtimi i objektit të propozuar të jetë të evidentueshme.

Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme në peisazh dhe vizualiteti.

Ndikimi në peisazhin e zones nuk është i dukshëm pasi objekti është egzistues vetëm do të bëhet një shtesë. Si përfundim perceptimi veçanërisht në distancë do të jetë i moderuar për faktin se kemi të bëjmë me zhvillim të objekteve të reja që ruan vijën ndërtimore të atyre egzistues.

Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme nga gjenerimi i mbetjeve

Në fazën ndërtimore, burimi kryesor i mbetjeve do të jetë aktiviteti ndërtimor, dhe mbetjet e krijuara nga punëtorët. Duke qënë se shumica e aktiviteteve të ndërtimit rezultojnë me mbetje të kufizuara e jo të rëndësishme, sidomos nga përdorimi i elementeve ndërtimor të parafabrikuar. Fraksionet e mbetjeve që do të krijohen si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit janë në lidhje me llojet e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë kryerjes së fazave të ndërtimit. Mbetjet e ngurta dhe sanitare do të prodhohen nga punëtorët gjatë qëndrimit të tyre në vendet e ndërtimit. Mbetjet e ngurta janë mbeturinat komunale me të njëjtën përbërje e të ngjashme me mbeturinat nga druri.

9. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

Ndikimi në mjedisin e zones do të ketë efektet e tij në një distancë jo shumë të gjatë, me dhjetra metra në një distancë jo më të largët se 200-300 m. Ky ndikim do të jetë i perkohshëm dhe nuk është me veti akumuluese në mjedis. Nuk shkarkohen elemente të demshme me afat të gjatë për mjedisin, si në atë ujor, për ajrin, tokën dhe për biodiversitetin. Ndikimi në peizazh do të jetë i perkohshëm për fazën e ndërtimit dhe i perhershëm nga ndërtimi i strukturave mbi tokë, ky impakt shtrin efektet e tij deri në disa metra.

Vlerat e ndikuara

Biodiversiteti

Duke qënë se vendi ku do të ndërtohet objekti është sipërfaqe tokë me objekt arsimin në një zonë të përqendruar rurale në përgjithësi karakterizohet me vlera të uleta për sa i përket biodiversitetit. Në kushtet e habitateve artificiale urbane dhe mungesë të specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara ndikimi është i papërfillshëm.

Fauna

Ndikimet në faunë është i ulët e jo i rëndësishëm, pasi nuk përfshijnë një numër të madh të organizmave, qëndrojnë në popullata të rregullata e të qëndrueshme ose që janë veçanërisht të ndjeshëm, të paaftë për të kompensuar humbjet në mënyrë të arsyeshme, ose janë tashmë të ulët në numër. Shpendet Ndikimi mbi zogjtë gjatë ndërtimit mund të vlerësohet si i moderuar dhe i kthyeshëm. Jovetebrore, amfibet dhe zvarraniket, dëmtimi e eliminimi nga automjetet përbën një efekt të mundshëm gjatë ndërtimit, që ndikon në shkatërrimin të drejtpërdrejtë të individëve rastësorë, si dhe faunës jovetebrore. Rëndësia e ndikimeve të mësipërme mund të vlerësohet e ulët dhe e papërfillshme.

Ujra nëntokësore

Nëse nuk merren masa, ndikimet e mundshme në cilësinë e ujërave nëntokësore janë vlerësuar të moderuar me probabilitet të ulët, të madhësisë së ulët. Ndikimet e mundshme negative në ujërat nëntokësore nga ujërat e zeza dhe mbetjeve të ngurta dhe të rrezikshme mund të vlerësohen në probabilitet të ulët, dhe me shtrirje lokale gjatë fazës së ndërtimit.

Ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të njëprobabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale.

Ndikimet në tokë

Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar e probabilitet të ulët duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdorimit të saj si dhe me shtrirje lokale. Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin racional të rrugëve ekzistuese hyrëse; Rehabilitimi i terrenit pas punimeve të ndërtimit nga ngjeshjet e krijuara. Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohet të një rëndësie të papërfillshme si dhe në masë të vogël.

10. Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit

Mundësia e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme

Rehabilitimi mjedisit të ndikuar është akti i restaurimit të mjedisit për ta kthyer atë në gjendjen origjinale, para ndikimeve në këtë rast nga zbatimi i projektit. Nëpërmjet rehabilitimit synohet mbrojtja e cilësive natyrore të trashëguara të mjedisit, mbrojtja e shendetit të punonjësve, mbrojtja e cilësisë së ujrave nëntoksore e sipërfaqësore, mbrojtja së cilësisë së tokës, ajrit, garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm në harmoni me mjedisin.

Kthimi i mjedisit në gjendje të mëparshme është një proces që përfshin zbatim masash e veprimesh që bëjnë përgatitjen e sistemit të terrenit të ndikuar, për parandalimin e erozionit, të ngjeshjes së metejshme të tokës, për gjelbërimin e rigjelbërimin, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në mënyrë të vazhdueshme që garanton shendetin e mjedisit.

Masat rehabilituese të përcaktuara në planin të rehabilitimit zbatohen duke kryer punime që adresojnë kërkesat teknike si dhe ato estetike e ekologjike.


Sistemi i sheshit tëndertimit të objekti tështë ngushtësisht i varur nga kërkesat teknike inxhinierike tëketij objekti, distancat e sigurisë, efektiviteti i përdorimit racional të tokës nëvartësi të parametrave teknik të projektit. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngusht me respektimin e kushteve teknike inxhinierike të projektit.

Shtresëzimet e sipërfaqeve të sheshit midis elementeve të ndërtimor të objektit, koridoret qarkulluese e të shërbimeve të mirëmbajtjes respektojnë rigorozisht kushtet teknike. Zona periferike jashtë sheshit është sipërfaqe e zhvilluar urbane me objekte banimi, rrugë e trotuare dhe duhet tërestaurohet në rastin e ndikimeve të paevitueshme duke ju referuar praktikave më mira restauruese e rehabilituese në tëresi që risjellin e promovojnë vlerat e pejsazhit si dhe cilësitëe kësaj zone urbane. Në këtë mënyrëndikohen në rritje tëcilësisë mjedisore urbane dhe në përmirsimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen nga erozioni etj.

Mundësimi i gjelbërimit në objekt nga projekti më të gjitha menyrat që lëjon një mjedis i tillë urban duhet të bëhet për të plotësim sa më maksimalisht kërkesat përmiruese e restauruese estetike dhe ekologjike. Llojet bimor që përdoren për rritjen e vlerave estetike mjedisore urbane janë në vartësi të volumit të kurores vegjetative të llojit, anës dekorative që prezanton si dhe dendësisë së përdorimit të llojit.

Sistemi i terrenit të ndikuar dhe përgatitja e vendit.

Nderhyrja e parë që behet për rehabilitimin e vendit është sistemi i tij, dhe siguri e ruajtja e vendit nga mosdëmtimi, gjatë punimeve rehabilituese. Masat e sugjeruara punimet e pastrimit e sistemit të vendit pas përfundimit të ndërtimit të objektit ndërtimor përfshijnë:



Veprimtaria	Efektet potencial e	Plani i minimizimit e zbutjes se ndikimit	Pergjegjesia	Kosto e përafert ne LEKE
Pastrimi e pergatitja e vendit ku zbatohet projekti	Ngjeshje e demtimi i strukturese se tokes se zones ne afersi	Rrethimi i sheshit te ndertimit. Ndalimi i nderhyrjeve te panevojshme ne afersi. Krijimi i sektorit te punimeve brenda sheshit dhe spostimet e nevojshme sipas kerkesave teknike e zhvillimore te objektit. Vendosja e tabelave	Zhvilluesi	20000 (pa elementet e sektorit)
Sistemimi i vendit te punes	Presioni ne sistemin drenazhues dhe erozionin e tokes	Berja e zbatimi i nje plani drenazhimi per mbrojtjen e tokes nga erozioni dhe evitimi i pellgjeve me uje.	Zhvilluesi	100,000
Hapjet e themeleve	Emetime ndotese ne ajer	Levizja e evadimet e dherave te behen ne kushtet e lagies per uljen e pluhura. Sperkatja e herepas-hershme e stoqeve, mbajtja e mjedisit paster.	Zhvilluesi	200,000
Punimet e ndertimit	Ndikimi me zhurmat e vibrimet	Pajisjet e ndertimit duhet te jene sipas Direktivave Standarteve te Komunitetit European 2000/14/EC, Maj. 2000. Kjo directive aplikohet tek prodhuesit e pajisjeve qe gjenerojne zhurma. Te gjitha pajisjet duhet te mbahen ne kushte te mira.	Zhvilluesi	Te vogla
Largimi i mbetjeve nga pastrimi i terrenit	Ndotja e ajrit, Ndikim ne ndotjen e tokes Ndikimi ne shendetin e punonjesve	Caktimi, i vendit te administrimit e trajtimit te mbetjeve. Marrja e lejeve nga Njesia e Qeverisjes lokale per vendosjen e dherave. Sigurimi i paisjeve personale mbrojtese nga pluhurat.	Zhvilluesi	100,000

13. Konkluzione

Ne kuadrin e zbatimit te ketij projekti, veprimtarite qe do te japin ndikime te mundshme negative ne mjedis gjate te gjitha fazave te ketij procesi, asaj parapregatitore, te ndertimit te objektit e te venies ne funksion jane veprimtarite ndertimore te cilat mund te ndikojne ne mjedisin biofizik dhe social – ekonomik. Per keto ndikime ky raport i VNM-se ka specifikuar masa konkrete zbutese te ndikimeve. Ne ketë raport janë parashtruar gjithashtu në mënyrë të detajuar dhe kërkesat mjedisore dhe sociale të fazës së venies në funksion dhe të mirëmbajtjes. Nga vleresimi i ndikimit në mjedis të ndertimit të objektit arrihet në keto perfundime:

Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndertimit rezultojnë të një rëndësie pothuajse të papërfillshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese. Nuk ka ndikim flora dhe fauna në përgjithësi, dhe në speciet endemike, të rralla ose të rrezikuara në veçanti, gjatë fazës së operimit.

Nuk janë parashikuar ndikime të rëndësishme, në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndertimit, për zonen e projektit. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë vlerësuar nga probabilitet e madhësi të ulët me shtrirje lokale. Ato mund të zbutet duke zbatuar praktikën e duhura për këto lloje të mbeturinave. Pasi zbatohen këto masa zbutëse, ndikimi i pritshëm mund të vlerësohet si i parëndësishëm.

Ndikimet e mundshme negative në ujërat nëntokësore nga ujërat e zeza dhe mbetjeve të ngurta dhe të rrezikshme mund të vlerësohen në probabilitet të ulët, dhe me shtrirje lokale gjatë fazës së ndertimit.

Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar e probabilitet të ulët duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdorimit të saj si dhe me shtrirje lokale. Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin e rrugëve ekzistuese hyrëse; Rehabilitimi i terrenit pas punimeve të ndertimit nga ngjeshjet e krijuara.

Per tektoninë e sizmitetin, do të jetë e nevojshme zbatimi i praktikave më të mira të përcaktuara në fazën e projektimit gjatë ndertimit të komponentëve të projektit të propozuar.

Aktivitetet e projektit duhet të marrë në konsideratë parametrat gjeologjike dhe kategorinë e tokës për të shmangur ndonjë ndikim eventual negativ të tilla si lëngëzimi e tokës, rrëshqitje, erozionit sedimentimit etj. Keto ndikime vlerësohet me probabilitet të ulët, me madhësi e shtrirjen lokale. Ato mund të zbuten duke shmangur rrëshqitje të tokës shkaktuara nga punimet e ndertimit. Me marrjen e masave zbutëse përmendura më sipër, ndikimet e mundshme do të vlerësohen të papërfillshme.

Ndikimi, i aktiviteteve të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndertimit, është i përkohshëm, i kthyesëm, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi të objektit dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhura. Nuk ka asnjë ndikim të rëndësishëm parashikuar nga projekti në cilësinë e ajrit gjatë fazës operacionale.

Ndikimet negative nga zhurmat dhe dridhjet e krijuara gjatë fazës së ndertimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ata janë vlerësuar